



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 161, Datë 15.08.2024

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN KORRIK 2024 PËR
KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.08.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1738/1 prot., datë 13.08.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Korrik 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. shkresën nr. 5178 prot., datë 05.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 1738 prot., datë 06.08.2024, ka përcjellë në ERE kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të muajit Korrik 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Bazuar në aplikimin e sipërcituar, për muajin Korrik 2024, shoqëria FSHU sh.a., e ka siguruar të gjithë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës së kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).
- Përllogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për këtë periudhë (ÇBEt), shoqëria e ka kryer duke u bazuar në të dhënat e profileve ditore të energjisë elektrike të prokuruar në bursë nga FSHU sh.a., çmimet orare të Tregut të Ditës në Avancë të ALPEX të muajit Korrik 2024 (Euro/kWh) si dhe vlerat rezultuese të faturave ditore. Të dhënat e mësipërme të paraqitura në formë tabelare i janë bashkëlidhur gjithashtu kërkesës për miratimin e çmimit të depozituar nga FSHU sh.a.

- Referuar aplikimit të shoqërisë FSHU sh.a., rezulton se është marrë në konsideratë kursi ditor i këmbimit (EURO/LEK), vlera të cilat janë bazuar në kurset zyrtare të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë për datat 28.06.2024 - 30.07.2024.
- Mbështetur në nenin 8 të *Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Korrik 2024 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.
 - **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** për periudhën 1 Maj 2022 – 31 Dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 72, datë 13.04.2022, është 0.85 lekë/kWh.
 - **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV**, në zbatim të vendimit të bordit të ERE nr. 365, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.
 - **Kostot administrative**, të cilat në zbatim të vendimit të bordit të ERE nr. 366, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, vijojnë të jenë 1.06 lekë/kWh.
- Në zbatim të *Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit*, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin *Korrik 2024*, përlllogaritjet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin Korrik 2024</i>			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	15.85
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.48
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA			19.79

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:
 - Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë *19.79 Lekë/kWh për muajin Korrik 2024*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin muajin Korrik 2024 prej 19.79 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI